



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neni 6 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 15 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”, neni 5 paragrafi 1, pika 1.3, neni 6 paragrafi 3 dhe neni 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 25.06.2026 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

VENDIM PARAPRAK për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridik, përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2

Parcela kadastrale P-70604014-00889-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 291 \text{ m}^2$ (dyqind e nëntëdhjetë e një metra katrorë), sipas Certifikatës së Pronës nr. 06-952-690/26, të datës 29.05.2026, në Zonën Kadastrale Dragash, e evidentuar në emër të Komunës së Dragashit, jepet në shfrytëzim për ndërtimin e objektit afaristo-banesor (banim me shumë njësi).

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenet 1 dhe 2 të këtij vendimi, është realizimi i interesit publik, sigurimi i përfitimit ekonomik për Komunën, funksionalizimi i pronës komunale, si dhe ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike.

Neni 4

OBLIGOHET Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024” dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS – DRAGASH

01 Nr. 060/01-1872-3126

Dt. 25.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit

Resul Fetahu





CERTIFIKATĚ / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJESIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70604014-00889-2

Numri lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

06-952-690/26

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

29.05.2026 - 10:05

Komuna / Opština / Municipality:

DRAGASH / DRAGAŠ / DRAGASH

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Dragash / Dragash / Dragast-

Zyrya Kadastrole Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

DRAGASH / DRAGAŠ / DRAGASH

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qauituar Mesto zvanio Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
DRAGASH-DRAGASH	0		30.11.2023	20.12.2023



A.2 LLOJ I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Tokë Ndërtimore/Građevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvoriste/Back Yard		291

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lichen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoli adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azuritirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Dragashit	600534938	DRAGASH / DRAGASH / DRAGASH /		BESELIDHJA	1/1	5-2002	30.11.2023






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : DRAGASH
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dragash

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70604014-00889-2	Parcelë / Parcela / Parcel	291



Shkalla/Razmera/Scale: 1:500

Punoi/Obradio/Created: Ferik Qemaledini

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note: K.P.



Data/ Data/Date: 03.06.2026

Koha/ Vreme/ Time: 10:52:25